

SYLLABUS I LËNDËS: Kompetencat menaxheriale

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ekonomisë
Titulli i lëndës:	Kompetencat menaxheriale
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga Dekanati
Mësimdhënësi:	Prof. asst. Liridon Veliu
Detajet kontaktuese:	liridon.veliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Kompetencat menaxheriale kategorizohen si kapital njerëzor i cili përkufizohet gjerësisht si njohuri dhe aftësi që kontribuojnë në produktivitetin e vendit të punës.</p> <p>Lënda “Kompetencat menaxheriale” synon ti mësoj studentët në lidhje me kuptimin, llojet e kompetencave menaxheriale, si dhe modelet e kompetencave të cilat kanë për qëllim përmirësimin dhe ngritjen e performancës në çdo organizate biznesi në efektivitetin menaxherial.</p> <p>Po ashtu, për të kuptuar rëndësinë e kompetencave menaxheriale, menaxherët duhet të jetë në gjendje për të identifikuar kompetencat për punë të ndryshme, të bëjnë dallimin në mes të kompetencave aktuale dhe të pritshme, të jetë në gjendje për të vlerësuar kompetencat e individit, për të kuptuar specifikat dhe zhvillimin e modeleve të kompetencave menaxheriale, për të mësuar se si të përdorin modelet e kompetencave në praktikë, të njihen me trendët e fundit në modelimin e kompetencës dhe efektivitetin menaxherial.</p>
Qëllimet e lëndës	<p>Kursi ka për qëllim që të mësoj studentëve kuptimin e kompetencës, kompetencës menaxheriale, llojet e tyre, zhvillimin e kompetencës menaxheriale dhe zbatimin e modeleve menaxheriale që kanë të bëjnë me përmirësimin e performances, si dhe formimin e modeleve të përshtatshme për t'u zbatuar në punën menaxheriale për një efektivitet menaxherial.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët duhet të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none">- Të kuptojnë dallimet në mes kompetencave menaxheriale dhe atyre organizative- Të kuptojnë rëndësinë e modeleve menaxheriale- Të kuptojnë lidhshmërinë në mes modeleve menaxheriale dhe efektivitetit menaxherial- Të njohin natyrën e kompetenca menaxheriale për nivele të ndryshme menaxheriale- Për të vlerësuar kompetencat e individit dhe ekipit

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	/	/	/
Rastet studimore	4	8	32
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokviume	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit	3	12	36
Përgatitja përfundimtare për provim	2	13	26
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	3	3
Projekte, prezantime	1	8	8
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies	<p>Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjërates, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupore, punimit të rasteve studimore individuale e grupore, vetëvlerësimeve periodike. Metoda e punës gjatë orëve të ligjëratave do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimin, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët. Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimin për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të lëndës.</p>		
Metodat e vlerësimit	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p> <p>a) vijueshmërisë në ligjërata: 5 pikë</p> <p>b) rastet studimore (si në vijim):</p> <p style="padding-left: 40px;">b₁) rasti studimor - punuar në mënyrë individual: 20 pikë</p> <p style="padding-left: 40px;">b₂) rasti studimor - punuar në mënyrë grupor: 15 pikë</p> <p>c) testi i parë: 30 pikë</p> <p>d) testi i dytë: 30 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.</p> <p><u>Shkallët e notave:</u></p> <p style="padding-left: 20px;">91-100% - nota 10 (dhjetë)</p> <p style="padding-left: 20px;">81-90% - nota 9 (nëntë)</p> <p style="padding-left: 20px;">71-80% - nota 8 (tetë)</p> <p style="padding-left: 20px;">61-70% - nota 7 (shtatë)</p> <p style="padding-left: 20px;">51-60% - nota 6 (gjashtë)</p> <p style="padding-left: 20px;">≤ 50 % - nota 5 (pesë)</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	- Gerardus Blokdyk: “Management Competencies”, 5STARCOOKS, June, 2021		

	<ul style="list-style-type: none"> - Sethumadhavan Lakshminarayanan: “Managerial Competencies, Self Efficacy, and Job Performance: A Path Analytic Approach”, SSRN, 2022 - Katarzyna Szczepańska-Woszczyna: “Management Theory, Innovation, and Organisation: A Model of Managerial Competencies (Routledge Advances in Management and Business Studies)”, Routledge, 2020 - Veliu L.: “Kompetencat menaxheriale”, Ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2023
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Liridon Veliu, “ Modelet e kompetencave menaxheriale”, (monografi shkencore), Lena, Prishtinë, 2021 - Liridon Veliu, “Sfidat e arsimit të lartë në zhvillimin e kompetencave menaxheriale”, (monografi shkencore), Lena, Prishtinë, 2021 - Gerardus Blokdyk, “Competency-based management A Complete Guide”, 5STARCooks, 2021 - Susan E. Jackson, John W. Slocum, Susan Hellriegel Leshnower, Don Hellriegel, Hellriegel Jackson S. “Instructor's Manual for Managing A Competency-Based Approach”, Eleventh Edition, ISBN 9780324536249, 2008 - Katarzyna Szczepańska-Woszczyna: “Management Theory, Innovation, and Organisation: A Model of Managerial Competencies (Routledge Advances in Management and Business Studies)”, Routledge, 2020 - Said Sayed, David Edgar: “Managerial competencies for organizational success: Examined frameworks for academics and professionals”, LAP LAMBERT Academic Publishing, 2020 - Macarena López-Fernández, Pedro M. Romero-Fernández: “Managerial Competencies for Multinational Businesses”, IGI Global, 2018 - Don Hellriegel, John W. Slocum, “Management”, Oxford University Press, Cape Town, South Africa, 2017 - M. Manxhari (2021), Sjellja në organizatë: (kuptimi dhe menaxhimi i aspektit njerëzor të organizatës), Pegi, Tiranë
Plani i dizajnuar i mësimi	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e I-rë:</i>	Prezantimi i syllabusit / Koncepti i kompetencave / Kompetencat gjenerike (përgjithshme) / Kompetenca specifike në aspektin e biznesit
<i>Java e II-të:</i>	Qasje teorike rreth esencës së kompetencave menaxheriale dhe kompetencave organizative
<i>Java e III-të:</i>	Karakteret e punës menaxheriale / Koncepti dhe përkufizimi i efektivitetit menaxherial / Parametrat e efektivitetit menaxherial / (Instruksione rreth përgatitjes së zhvillimit të intervistës për realizim më menaxher)

<i>Java e IV-të:</i>	Menaxhimi i bazuar në kompetenca / (Instruksione rreth përgatitjes së zhvillimit të pyetësorit për realizim më menaxher)
<i>Java e V-të:</i>	Modelet e kompetencave menaxheriale
<i>Java e VI-të:</i>	Llojet e kompetencave menaxheriale; 1. Komunikimi Dimensioni i komunikimit si kompetencë menaxheriale: a) Komunikimi formal; b) Komunikimi jo formal; dhe c) Negocimi - Prezantim i rasteve studimor (individual) - Diskutime
<i>Java e VII-të:</i>	2. Puna në grup; Dimensioni i punës në grup si kompetencë menaxheriale: a) Ndërtimi i grupit në mënyrë të duhur; b) Krijimi i një ambienti mbështetës për grupin; dhe c) Menaxhimi i dinamikave të grupit në mënyrë të përshtatshme - Prezantim i rasteve studimor (individual)
<i>Java e VIII-të:</i>	Testi i parë
<i>Java e IX-të:</i>	3. Vetë menaxhimi; Dimensioni i vetë-menaxhimit si një kompetencë menaxheriale: a) Integriteti dhe sjellja etike; b) Motivet (shtytësit) personal dhe elasticiteti; c) Balancimi i punës dhe çështjeve jetësore; dhe d) Vetëdijesimi dhe zhvillim personal - Prezantim i rasteve studimor (individual) - Diskutime
<i>Java e X-të:</i>	4. Veprimi strategjik si kompetencë menaxheriale; Dimensioni i veprimit strategjik si kompetencë menaxheriale: a) Njohja e industrisë; b) Njohja e organizatës; dhe c) Marrja e veprimeve strategjike - Prezantim i rasteve studimor (grupor)
<i>Java e XI-të:</i>	5. Planifikim dhe drejtimi; Dimensioni i planifikimit dhe drejtimit si kompetencë menaxheriale: a) Mbledhja e informacioneve; b) Analiza dhe zgjidhja e problemeve; c) Planifikimi dhe organizimi i projekteve; d) Menaxhimi i kohës; dhe e) Buxhetimi dhe menaxhimi financiar - Prezantim i rasteve studimor (grupor) - Diskutime

<i>Java e XII-të:</i>	<p>6. Ndjeshmëria ndaj kulturave të ndryshme; Dimensioni i zhdërvjelltësisë dhe ndjeshmërisë ndaj kulturave të ndryshme si një kompetencë menaxheriale:</p> <p>a) Njohja dhe kuptimi i kulturave; b) Qasja ndaj njohjes së kulturave; c) Njohja, vlerësimi dhe përgjigjja ndaj diversitetit politik, kulturor dhe çështjeve ekonomike brenda dhe përtej vendit; dhe d) Pranimi i dallimeve gjuhësore dhe gjuhëve tjera</p> <p>- <i>Prezantim i rasteve studimor (grupor)</i></p>
<i>Java e XIII-të:</i>	Prezantimi i rasteve studimore (<i>individual / grupor</i>)
<i>Java e XIV-të:</i>	Rëndësia e inteligjencës emocionale për menaxherët
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shitesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit.</p> <p>Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.</p> <p>Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.</p>	